

## Hapet thirrja për bursa studimi për studentët e UMT, në Universitetin Politeknik të Valencias, Spanjë në kuadër të programit Erasmus +.

### Mobiliteti dhe kohëzgjatja e bursave:

Studentët do të studiojnë semestrin e dytë të vitit akademik 2024-2025 në Universitetin Politeknik të Valencias, Spanjë

### Kush mund të aplikojë:

Mund të aplikojnë studentët e UMT të cilët gjatë vitit akademik 2024-2025 do të jenë në vitin e *dytë dhe të tretë*, të ciklit *bachelor* si edhe studentët e vitit të *parë dhe të dytë master*, në fushat/fakultetet:

- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT (bachelor dhe master);
- Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës

*\*\*\*\*Dega Arkitekturë (mund të aplikojnë vetëm studentët që gjatë vitit akademik 2024-2025 do të jenë në vitin e tretë të studimeve)*

*Lëndët të cilat zhvillohen në universitetin pritës në semestrin e dytë i gjeni duke klikuar në linkun:*  
<http://www.upv.es/entidades/OPII/infoweb/pi/info/818871normali.html>

### Gjuha e mësimdhënies:

Mësimdhënia do të jetë në gjuhën angleze.

### Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (850 EUR në muaj);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

### **Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Vërtetim dhe Listë notash e ciklit aktual të studimit;
- Kopje e pasaportës;
- Fotokopje e Certifikatës/dëshmi e gjuhës angleze ose dokument që vërteton njohuritë në këtë gjuhë. Niveli i kërkuar B2; Nëqoftëse mungon certifikata e njohur ndërkombëtarisht atëherë pajisuni me një certifikatë nga Profesori i gjuhës angleze në UMT;
- Letër motivimi;
- CV;
- Dokumenti Learning Agreement.

### **Komisioni Përzgjedhës do të marrë parasysh kriteret e mëposhtme në përzgjedhjen e të gjithë kandidatëve:**

- GPA (deri në 5 pikë);
- Certifikatë e gjuhës angleze/Certifikatë e gjuhës spanjolle (B2 4 pikë, C1 4.5 pikë dhe C2 5 pikë);
- Letra e motivimit (deri në 5 pikë);
- CV e aplikantit (deri në 5 pike)

Për më shumë informacion në lidhje me hapat e mobilitetit klikoni:  
<https://www.upv.es/entidades/OPII/infoweb/pi/info/818854normali.html>

Afati për aplikim: **8 Shtator, 2024**

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentet të skanuara me e-mail në adresën [iro-projects@umt.edu.al](mailto:iro-projects@umt.edu.al) ose dorazi në Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë në Universitetin Metropolitan Tirana.

***UMT ju uron shumë suksese në aplikimin tuaj!***